

20221642561

LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT TË REALIZIMIT TË BUXHETIT TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT PËR VITIN 2022

Neni 1

Në Ligjin e Realizimit të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2022 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut numër 287/21), në nenin 18, pas paragrafit 1, shtohet paragraf i ri 2 siç vijon:

“Nëse të punësuarit i sigurohet akomodimi dhe ushqimi gjatë udhëtimit të punës në vend, të punësuarit i takon 20% e mëditjes së përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni.”.

Neni 2

Në nenin 23, pas paragrafit 2, shtohen dy paragrafe të rinj 3 dhe 4, si në vijim:

“Mjetet e përcaktuara në nëndarjen 040.01 - Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, nënprogrami 16 - përkrahja për shtypjen dhe distribuimin e medieve të shkruara, shfrytëzohen sipas programit të miratuar paraprak nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, me propozim të Sekretariatit të Përgjithshëm të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut”.

“Mjetet e përcaktuara në ndarjen 040.01 – Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, nënprogrami P 1 – masat për ballafaqimin me krizën Covid-19 dhe masat tjera antikrizë, shfrytëzohen me vendim të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, për të përkrahur qytetarët, institucionet dhe ekonominë me qëllim të tejkalimit të situatave në raste të paparashikueshme.”.

Neni 3

Në nenin 33, paragrafi 2, pas fjalëve "zëri 464 - Transferta të ndryshme" presja zëvendësohet me lidhëzën "dhe" dhe shtohen fjalët "zëri 489 - Subvencione kapitale për ndërmarrjet dhe organizatat joqeveritare,".

Paragrafi 4 ndryshohet dhe bëhet:

“Mjetet e përcaktuara në ndarjen 140.01 - Ministria e Bujqësisë, e Pylltarisë dhe e Ekonomisë së Ujërave, Nënprogrami 60 - Ekonomia e Ujërave, zëri 423 - Materiale dhe inventar i imët, zëri 480 - Blerja e pajisjeve dhe makinerive, zëri 482 – Objekte të tjera ndërtimore dhe zëri 485 - Investime dhe mjete jofinanciare, shfrytëzohen sipas programit të miratuar paraprak nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, me propozim të Ministrisë së Bujqësisë, të Pylltarisë dhe të Ekonomisë së Ujërave.

Neni 4

Në nenin 34 pas fjalëve “Nënprogrami 21 – Fondi intervenues për bujqësi, zëri 464 – Transferta të ndryshme”, shtohen fjalët “Nënprogrami 22 – Nxitja e konsumit të frutave të freskëta, perimeve, qumështit dhe produkteve të qumështit, zëri 464 – Transferta të ndryshme”.

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut.